



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-23-0534

Në çështjen juridike të:

Paditësi/ Ankuesi

R S, nga fshati P, Komuna e Novobërdës

Kundër:

E paditura

N.SH "Agrokultura" (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Gazmend Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit AC-I-23-0283 datë 20 korrik 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 mars 2025, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Kërkesa për rishqyrtimin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS AC-I-23-0283 datë 20 korrik 2023 hedhet poshtë si e papranueshme.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 1 gusht 2014, paditësi përmes postës e dorëzoi në DHPGJS ankesë dhe ka pohuar se ka qenë punëtor i NSH "Agrokultura" në Gjilan, dhe njëherit kërkoj përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejtë pjesëmarrje në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH.

Shkalla e parë e DHPGJS, me Aktvendimin e saj, C-II-19-0022-C0001 datë 13 prill 2023, ankesën e paditësit/ankuesit e ka hedhur poshtë si të papranueshme.

Kundër Aktvendimit, si më lartë, paditësi me 15 maj 2023 parashtroj ankesë.

Kolegji i Apelit, me Aktvendimin e saj AC-I-23-0283 datë 20 korrik 2023, ankesën e paditësit/ankuesit e ka refuzuar si të pabazuar dhe Aktvendimin e ankimuar, C-II-19-0022-C0001 datë 13 prill 2023 e vërtetoi.

Paditësi/Ankuesi, me 13 shtator 2023, kundër Aktvendimin të Kolegjit të Apelit AC-I-23-0283 datë 20 korrik 2023, parashtroj një kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit. Kjo kërkesë është parashtruar, nga ana e përfaqësuesit të paditësit, S Z, B.J. "I C".

Paditësi/Ankuesi propozoj që kërkesa e tij të aprovohet dhe Aktvendimi i Kolegjit të apelit, siç thuhet të hedhet si i pabazuar.

Me 4 mars 2025, u lëshua një urdhër për përfaqësuesin e ankuesit respektivisht ankuesin, me anë të cilit në bazë të nenit 33.1 lidhur me nenin 32.1 të Ligjit (nr. 06/L-086) për DHPGJS, ju kërkua që të dëshmohet se përfaqësuesi i ankuesit është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës.

Duke vepruar sipas urdhrit, si më lartë, paditësi/ankuesi me parashtrësën e parashtruar pranë DHPGJS me 12 mars 2025, informoj gjykatën se do ta përfaqësoj vet-veten. Me po këtë parashtrëse, shihet ndryshimi i adresës së ankuesit/paditësi tani në fshatin P.

Kolegji i Apelit nuk ndërmori veprime të mëtutjeshme procedurale.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa për rishikim e paditësit/ankuesit konsiderohet e palejuar.

Në rastin konkret sipas nenit 9 paragrafi 14 i Ligjit (nr. 06/L-086) për DHPGJS, të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.

Në interpretim të dispozitës ligjore, si më lartë të cituar, me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-23-0283 datë 20 korrik 2023, me të cilin është vërtetuar Aktvendimi shkallës së parë, C-II-19-0022-C0001 datë 13 prill 2023, çështja e paditësit/ankuesit konsiderohet përfundimisht e përfunduar dhe si e tillë çështje e gjykuar. Mjetet tjera juridike, përfshirë edhe kërkesën për rishikim, nuk mund të ushtrohen dhe konsiderohen të palejuara.

Mjeti i vetëm juridik, sipas nenit 9 paragrafi 15 të Ligjit për DHPGJS, kundër Vendimeve- Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit, të cilët palëve të pakënaqura ju lejohen është ushtrimi kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese.

Andaj Kolegji i Apelit nuk hyn në shqyrtim të çështjes në merita të saj dhe se në bazë të nenit 9.10 të Ligjit për DHPGJS, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Sipas nenit 13.8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2007 për unifikimin e taksave gjyqësore, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i mbulon shpenzimet e veta.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 20 mars 2025.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues
